
BULETIN INFORMATIV

GUSHT 2025

AKADEMIA E SHKENCAVE
E SHQIPËRISË



**Buletin mujor i aktiviteteve të Akademisë së
Shkencave të Shqipërisë**

Gusht, 2025

Përmbajtje

Aktivitete	5
Objekti muzeor me vlera unike "Kalorësi i Babunjës" shënoi numër rekord me 219.397 vizitorë në Vjenë	6
Nga Vjena në Tiranë, kthehet në atdhe vepra arkeologjike "Kalorësi i Babunjës"	7
U mbajt në Shkodër seminari XVIII për mësuesit e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë	9
Nga 29 shtatori deri më 3 tetor 2025, Shqipëria do të presë për të pestin vit radhazi kongresin ndërkombëtar të nanoshkencës dhe nanoteknologjisë, "NanoBalkan2025"	11
Dr. Stefano Romano, studiuesi i artit për hapësirën publike dhe arkitekturën pranë Qendrës së Studimit të Arteve, ASHSH, ishte i ftuar në qytetin e Bergamos (Itali) në kuadër të projektit "Interscape", ku prezantoi edhe punën e tij kërkimore pranë QSA-së.	13
Dr. Anxhela Cikopano merr pjesë në edicionin e XI të Kongresit Botëror të Këshillit Ndërkombëtar për Studimet e Evropës Qendrore dhe Lindore	14
Prof. asoc. dr. Rovenë Vata Mikeli, punonjëse shkencore e Departamentit të Studimeve Letrare, të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, mori pjesë në konferencën shkencore: "At Gjergj Fishta dhe Malcia"	15
Pjesëmarrje e studiuesve të ASHSH-së në "Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare"	17
"Refleksion për disa shkrime të mia të viteve 1980-1992 kushtuar Bajram Currit" nga Marenglen Verli	18
"Dyfishimi si proces fjalëformues në gjuhën shqipe" nga Adelina Çerpja	19
"Rregulli i përdorimit emfatik dhe joemfatik të nyjave të përparme në shqipe: sjellje klitike dhe bifunksionalitet morfosintaksor" nga Aristotel Spiro	20
"Çështje të diferencimit tekstual e semantik në brendinë e teksteve të vjetra shqipe" nga Evalda Paci	22
Të tjera	24
Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë uron akademik emeritus Rexhep Meidanin: Gëzuar ditëlindjen!	25

In memoriam	26
Kujtojmë në ditën e tij të lindjes Eqerem Çabej	27
Akademia e Shkencave kujton me nderim, në ditën e lindjes, themeluesin e arkeologjisë shqiptare Hasan Cekën	29
Më 30 gusht 2025 mbushen 11 vjet nga largimi nga jeta i akademikut të nderuar, prof. dr. Shaban Demiraj	31
Ngushëllim për ndarjen nga jeta të Robert Papavramit	38
Ngushëllim për ndarjen nga jeta të Artur Zhejit	39
Ngushëllim për ndarjen nga jeta të Naun Shundit	40

Aktivitete

Objekti muzeor me vlera unike "Kalorësi i Babunjës" shënoi numër rekord me 219.397 vizitorë në Vjenë

Në përfundim të ekspozimit në Muzeun e Historisë Natyrore në Vjenë, objekti muzeor arkeologjik "Kalorësi i Babunjës" ka arritur të shihet nga 219.397 vizitorë gjatë tre muajve.



Lajmin për numrin e vizitorëve e ka deklaruar drejtoresha e këtij muzeu, prof. Katrin Vohland.

Kalorësi i Babunjës, vepër arti me vlera unike, është pjesë e fondeve arkeologjike të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Ekspozimi u mundësua nga marrëveshja e nënëshkruar mes Institutit të Arkeologjisë, pjesë e ASHSH, dhe Muzeut të Historisë Natyrore të Vjenës. Krahas ekspozimit të Kalorësit të Babunjës, u organizua edhe një konferencë shkencore e përbashkët me palën austriake me fokus këtë zbulim unik 2600-vjeçar të arkeologjisë.

Objekti qëndroi i ekspozuar në "Sallën e Artë" të Muzeut të Historisë Natyrore në Vjenë nga data 13 maj deri më 31 korrik 2025.

"Kalorësi i Babunjës" u kthye në Shqipëri më 4 gusht 2025.

www.akad.gov.al

Nga Vjena në Tiranë, kthehet në atdhe vepra arkeologjike “Kalorësi i Babunjës”

Sot, më 4 gusht 2025, skulptura e rrallë prej bronzi, “Kalorësi i Babunjës”, u rikthye në Shqipëri pas një ekspozite prestigjioze dymujore në Muzeun e Historisë Natyrore në Vjenë (Museum of Natural History Vienna). Objekti qëndroi i ekspozuar në “Sallën e Artë” të muzeut nga data 13 maj deri më 31 korrik 2025.



Ekspozita u ideua dhe u organizua nga Ambasada e Shqipërisë në Vjenë në bashkëpunim me Institutin e Arkeologjisë, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, dhe Muzeu i Historisë Natyrore në Vjenë.

Sipari i kësaj ekspozite u hap me konferencën shkencore me temën “Roli i elitave në mijëvjeçarin e parë p.e.s. midis Europës Qendrore dhe Ballkanit Jugor – me rastin studimor të “Kalorësit të Babunjës”, ku morën pjesë mbi 120 studiues nga e gjithë bota, në të cilën Akademia e Shkencave e Shqipërisë u përfaqësua nga akad. Adem Bunguri; prof. Neritan Ceka; prof. Bashkim Lahi dhe prof. asoc. Eduard Shehi.

Vepra unike 2600-vjeçare, e zbuluar në vitin 2018 pranë Apolonisë (Babunjë, Lushnjë), rikthehet në Tiranë pas një jehone ndërkombëtare, për t’u vendosur në Muzeun Arkeologjik, pjesë e Institutit të Arkeologjisë, ASHSH.



Për më shumë rreth kësaj ekspozite, shih linqet:

<https://ata.gov.al/.../kaloresi-2600-vjecar-i-zbuluar.../>

<https://www.youtube.com/watch?v=GSZ7v4MF38s>

<https://www.cna.al/.../kaloresi-i-babunjes-shqiperia...>

<https://www.voxnews.al/.../kaloresi-i-babunjes-statuja...>

<https://kohajone.com/.../kthehet-me-kalerimin-e-tij-epik.../>

<https://euronews.al/kaloresi-prej-bronzi-zbulimi-i.../>

<https://sot.com.al/.../kaloresi-i-babunjes-veper-2600.../>

<https://apel.media/kaloresi-i-babunjes-thesari-2600...>

www.akad.gov.al

U mbajt në Shkodër seminari XVIII për mësuesit e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë

- Prof. asoc. dr. Anila Kananaj, koordinatoreja e projektit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë "Fjalori i madh i gjuhës shqipe", mbajti referimin me temën "Përdorimi i 'Fjalorit të madh të gjuhës shqipe' online në mësimin e gjuhës amtare"-

Në kuadër të Seminarit XVIII për mësuesit e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë, sot në Shkodër, koordinatoreja e projektit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për Fjalorin e Madh të Gjuhës Shqipe, prof. as. dr. Anila Kananaj, mbajti referimin

'Përdorimi i Fjalorit të Madh të Gjuhës Shqipe online në mësimin e gjuhës amtare'.



Ky referim shqyrtoi potencialin e përdorimit të Fjalorit të madh të gjuhës shqipe (FMGJSH) online, me rreth 120,000 fjalë, përfshirë mbi 11,000 shprehje frazeologjike, si mjet dinamik për nxënien dhe mësimdhënien e gjuhës amtare. Historikisht, fjalorët kanë shërbyer si mjete për zhvillimin e gjuhës. Ofrimi falas i FMGJSH online mundëson rritjen e aksesit dhe të angazhimit për mësuesit dhe nxënësit. Ky burim, i cili mund të përdoret si në shtëpi ashtu edhe në klasë, ofron referenca të menjëhershme, të paanshme dhe të besueshme për të rritur saktësinë e drejtshkrimit dhe të njohjes së një sërë elementeve kuptimorë e leksiko-gramatikorë të gjuhës shqipe. Gjithashtu, FMGJSH ofron një rrjet të gjerë sinonimesh, antonimesh dhe shprehjesh frazeologjike, të

dobishme për pasurim leksikor dhe shumëllojshmëri stilistike.


Për më tepër, FMGJSH në internet siguron një përvojë argëtuese dhe tërheqëse të të nxënit të gjuhës. Të nxënit aktiv mund të inkurajohet dhe aftësitë gjuhësore mund të forcohen përmes ushtrimeve që angazhojnë nxënësit të plotësojnë sfida me shprehjen frazeologjike të ditës, me lojëra fjalori që i referohen fjalëve të reja a të rralla, me përdorimin në fjali të fjalëve të lidhura tematikisht, me krijimin e vargjeve me rimë etj.

Si përfundim, përfshirja e leksikografisë digjitale në pedagogjinë e gjuhës amtare promovon një përvojë të të nxënit, më dinamike, të individualizuar e argëtuese, duke ndihmuar njëkohësisht në ruajtjen e kulturës shqiptare.

www.akad.gov.al

Nga 29 shtatori deri më 3 tetor 2025, Shqipëria do të presë për të pestin vit radhazi kongresin ndërkombëtar të nanoshkencës dhe nanoteknologjisë, “NanoBalkan2025”

“NanoBalkan2025” organizohet nga Fondacioni Phantoms dhe ICN2, Instituti Katalanas i Nanoshkencës dhe Nanoteknologjisë (Spanjë), NanoBalkan – Qendra Rajonale e Nanoshkencës dhe Nanoteknologjisë pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë), Universiteti i Tiranës, Projekti SUSNANO dhe në bashkëpunim me institucione kryesore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe projekte të BE-së.



Edicioni i 3-të i Konferencës Ndërkombëtare NanoBalkan (NB2025) vjen pas suksesit të jashtëzakonshëm të katër ngjarjeve të fundit të organizuara në Shqipëri, përkatësisht TNT2021, TNT nanoBalkan2022, NanoBalkan2023 dhe NanoBalkan2024.

Ky takim i ri shkencor i nivelit të lartë synon të paraqesë një gamë të gjerë të kërkimeve aktuale në nanoshkencë dhe nanoteknologji, si dhe politika e iniciativa të lidhura me to, të tilla si NANOBALKAN, Qendra Rajonale e Nanoshkencës dhe

Nanoteknologjisë.

Struktura e nanoBalkan2025 do të ruajë tiparet themelore të ngjarjeve të mëparshme të organizuara në Shqipëri për 4 vjet rresht, duke ofruar një mundësi unike për ndërveprim të gjerë në fusha të ndryshme të nanoshkencës dhe nanoteknologjive, duke përfshirë Materialet 2D, të mësuarit automatik dhe inteligjencën artificiale.

Me rastin e “NanoBalkan2025” do të organizohen disa sesione me tema të nxehta për nanoteknologjinë, kërkimin në nanomjekësi, aplikimet e nanoteknologjisë në gjenetikë etj, si lëndë të para me interes rajonal dhe ndërkombëtar.

Për më tepër, lexo linkun:

<https://www.facebook.com/share/p/1DWi1D1g6d/?mibextid=wwXIfr>

www.akad.gov.al

Dr. Stefano Romano, studiuesi i artit për hapësirën publike dhe arkitekturën pranë Qendrës së Studimit të Arteve, ASHSH, ishte i ftuar në qytetin e Bergamos (Itali) në kuadër të projektit "Interscape", ku prezantoi edhe punën e tij kërkimore pranë QSA-së.

Studiuesi i artit në hapësirën publike dhe arkitekturës pranë Qendrës së Studimit të Arteve, dr. Stefano Romano ishte i ftuar në qytetin e Bergamos (Itali) si "visiting professor" në kuadër të projektit "Interscape", ku prezantoi edhe punën e tij kërkimore pranë QSA-së.



Projekti i organizuar nga Politecnico delle Arti të Bergamos, ka si qëllim reflektimin mbi konceptin e peizazhit urban. Gjatë programit një-javor të shkollës verore u organizuan seminare, tryeza të rrumbullakëta, punëtori dhe "masterclass"-e për studentët pjesëmarrës nga politeknikët partnerë të Xhenovës, Firences, Ravenës, Malagës, Madridit, Luçernës dhe Novi Sadit. Projekti "Interscape" do vazhdojë gjatë gjithë vjeshtës e dimrit dhe do kurorëzohet me një ekspozitë të punimeve të realizuara nga studentët në hapësirat e GAMeC (Galleria d'Arte Moderna e Contemporanea) në Bergamo.

www.akad.gov.al

Dr. Anxhela Cikopano merr pjesë në edicionin e XI të Kongresit Botëror të Këshillit Ndërkombëtar për Studimet e Evropës Qendrore dhe Lindore

Gjatë panelit “Dekada e gjatë e viteve 1990 në Shqipëri: Zhbërja e trashëgimisë socialiste dhe rimodelimi i vendit nga neoliberalizmi i pas Luftës së Ftohtë” (“The Long 1990s in Albania: How post-Cold War Neoliberalism Unmade the Socialist Legacy and Remade the Country”) në kuadrin e edicionit të XI të Kongresit Botëror të Këshillit Ndërkombëtar për Studimet e Evropës Qendrore dhe Lindore (XI World Congress of the International Council for Central and East European Studies), i cili u mbajt në Londër dhe specifikisht në UCL (University College London) mes datave 23-25 korrik 2025, dr. Anxhela Cikopano mbajti kumtesën e titulluar “(Neo)liberalizimi i Teatrit Kombëtar të Shqipërisë” ([Neo]liberating the Albanian National Theatre”). Kumtesa trajtonte institucionin e Teatrit Kombëtar si një nga më të prekurit, si në planin e cënimit të pronës publike për t’u shndërruar në private, ashtu edhe në procesin e vështirë të politikave neoliberalizuese, që u perceptuan apo u shitën si reforma tranzicioni. Protesta të përsëritura nga artistët dhe publiku shpërthyen si reagim ndaj përpjekjeve për të çmontuar jo vetëm godinën, por edhe vetë konceptin e Teatrit Kombëtar si një entitet kulturor dhe institucional – i paraqitur nga diskursi zyrtar si një strukturë e vjetëruar dhe e sëmurë. Ndërsa shembja e godinës së Teatrit Kombëtar përfaqëson rezultatin më të dukshëm të ndërhyrjes (neo)liberale, (neo)liberalizimi i Teatrit Kombëtar përfshin një grup më të gjerë mekanizmash, si tërheqjen e mbështetjes shtetërore dhe shtytjen drejt vetëfinancimit, copëzimin institucional të teatrove që përbënin entitetin e Teatrit Kombëtar, si dhe taktika të privatizimit, pasojat afatgjata të të cilave shpesh janë nënvlerësuar ose harruar në rrjedhën e historisë bashkëkohore.

Prof. asoc. dr. Roven Vata Mikeli, punonjëse shkencore e Departamentit të Studimeve Letrare, të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, mori pjesë në konferencën shkencore: “At Gjergj Fishta dhe Malcia”

Më datë 16 gusht 2025, prof. asoc. dr. Roven Vata Mikeli, punonjëse shkencore e Departamentit të Studimeve Letrare, të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, mori pjesë në konferencën shkencore: “At Gjergj Fishta dhe Malcia”, e organizuar nga Shoqata Atdhetare “Kulla e Bajraktarit të Hotit” dhe Muzeu Malësia, e mbajtur në Kullën e Çun Mulës, Kushe Hot, Malësi e Madhe.



Prof. asoc. dr. Roven Vata Mikeli u paraqit me kumtesën me titull: “Roli i Gjergj Fishtës në formësimin e identitetit shqiptar”, ku po paraqesim një përmbledhje të kësaj kumtese:

Gjergj Fishta (1871-1940) ishte një nga përfaqësuesit më të shquar të letërsisë dhe të kulturës kombëtare shqiptare, publicist, atdhetar, diplomat dhe klerik me vlera të rralla shpirtërore dhe intelektuale. Ai paraqet figurën më madhore dhe më të fuqishme të letërsisë shqiptare të gjysmës së parë të shekullit të njëzetë, i cili më shumë se cilido, shkrimtar tjetër i dha shprehje artistike shpirtit kërkues të shtetit të ri sovran shqiptar, ku më të drejtë është cilësuar si Homeri i letërsisë shqiptare, si shkëmb i shpirtit dhe shkëmb i tokës shqiptare, si poet kombëtar etj.

Gjergj Fishta është ndër të parët e ndër më të mëdhenj atdhetarë, të cilët në kohët më të vështira bënë çmos për t'a mbajtur gjallë lëvizjen kombëtare kundër dhunës barbare të qeverisë turke, kundër lakmisë dhe parake serbe dhe kundër propagandës greke. Kudo që shtohet çështja e Shqipërisë, Gjergj Fishta gjendej aty pranë e, ku me vepra, e ku me shkrime, sidomos me poezinë e tij të gjallë, zgjonte nga gjumi më të plogështit dhe mbante gjallë gjithmonë shpresën e ardhmërisë.

I njohur me epin e tij "Lahuta e Malcis", si një ep me diskurs patriotik, Gjergj Fishta shkëlqeu, përmes talentit të tij, në satirikë, dramatikë, lirikë dhe publicistikë. Në këtë të fundit, Gjergj Fishta u bë i njohur edhe për diskursin e tij politik, qoftë lokal apo ndërkombëtar, gjithsesi të ndërlidhur me çështjen kombëtare.

www.akad.gov.al

**Pjesëmarrje e studiuesve të
ASHSH-së në “Seminarin
Ndërkombëtar për Gjuhën,
Letërsinë dhe Kulturën
Shqiptare”**

“Refleksion për disa shkrime të mia të viteve 1980-1992 kushtuar Bajram Currit” nga Marenglen Verli



Pa dyshim, Bajram Curri është një nga figurat më të shquara të Lëvizjes sonë Kombëtare, të dekadës së fundit të shek. XIX dhe të dekadave të para të shek. XX, për liri, pavarësi, bashkim kombëtar, emancipim e demokraci. Ai ishte një figurë qendrore përkrah Ismail Qemalit, Hasan Prishtinës, Isa Boletinit, Th. Gërmenjit, F. S. Nolit, A. Rrustemit, H. Xhelos etj. Jo rastësisht ai është vlerësuar si Hero i Popullit pas Luftës së Dytë Botërore nga shteti shqiptar; jo rastësisht, nga pena e ndritur e bashkëkohësit të tij, Fan S. Noli, ishte quajtur “trim-tribun i vegjëlisë” dhe “div-dragoi i Dragobisë” etj. etj. Ai ishte jo vetëm luftëtar i shquar, por njëkohësisht ndër udhëheqësit kryesorë më të dashur për popullin e Malësisë së Kosovës. Përkrahës i Haxhi Zekës në Lidhjen Shqiptare të Pejës, në vitin 1899, njëri ndër drejtuesit politikë e ushtarakë të Kryengritjes Antiosmane të vitit 1912, figurë qendrore në shpartallimin e bandave esadiste dhe në mbrojtjen e Koplikut kundër intervencionistëve jugosllavë në vitin 1920, “pushka e parë dhe më e mbarë” në zhvillimet politiko-ushtarake të vitit 1924, Bajram Curri spikati ndër bashkëkohësit. Por, në atë periudhë shumë komplekse, shumë të rrezikshme për shtetin shqiptar, me shumë probleme të mbartura për të ardhmen e trevave shqiptare të copëtuara më 1913 dhe të mbetura jashtë edhe me vendimet e Fuqive të Mëdha më 1920, në atë periudhë ballafaqimesh të ashpra politike e ushtarake ndërshtetërore, ai u orientua gjithnjë drejt “Plaku i maleve”. Pikërisht për këtë do të flitet në këtë kumtesë.

“Dyfishimi si proces fjalëformues në gjuhën shqipe” nga Adelina Çerpja



Dyfishimi përfaqëson një proces fjalëformimi ende të patrajtuar në mënyrë sistematike në traditën gjuhësore shqiptare. Ky punim synon të analizojë pozicionin dhe funksionin e tij në sistemin fjalëformues të shqipes, duke e parë atë në raport me produktivitetin dhe kreativitetin morfologjik. Ndonëse shpesh konsiderohet një proces periferik krahasuar me prejardhjen dhe kompozimin, dyfishimi përfshin struktura të qëndrueshme dhe të përdorura gjerësisht në shqipen bashkëkohore, me rëndësi të dukshme gramatikore dhe komunikative.

Analiza mbështetet në një qasje sinkronike dhe përqendrohet në format ekzistuese të dyfishimit të nxjerra nga disa fjalorë të shqipes, duke u ndalur te tiparet e tyre morfofonologjike, transparenca semantike dhe motivimet që qëndrojnë pas krijimit të tyre. Vëmendja është përqendruar te një analizë cilësore, duke interpretuar funksionet e këtyre formimeve në kontekstin e përdorimit aktual.

Një vend të rëndësishëm zë klasifikimi formal i llojeve të dyfishimit në gjuhën shqipe dhe funksionet që ato realizojnë, si dhe faktorët konkretë që ndikojnë në mundësinë e leksikalizimit të këtyre formimeve. Në këtë kuadër, dyfishimi vlerësohet jo vetëm si një dukuri gramatikore, por edhe si shprehje e krijimtarisë gjuhësore.

Fjalë kyçe: dyfishim; fjalëformim; morfologji e shqipes; leksikalizim; lokucione; morfologji; kreativitet morfologjik.

“Rregulli i përdorimit emfatik dhe joemfatik të nyjave të përparme në shqipe: sjellje klitike dhe bifunksionalitet morfosintaksor” nga Aristotel Spiro



Në sintagmën emërore të shqipes, rregulli i përdorimit emfatik dhe joemfatik të nyjave të përparme mbështetet mbi ndërveprimin midis gjymtyrës kryesuese (emrit të përcaktuar) dhe gjymtyrës së varur (përcaktorit), si dhe mbi sjelljen morfosintaksore të vetë nyjës.

Përdorimi i nyjës emfatike ose joemfatike përcaktohet nga dy faktorë themelorë: (1) trajta morfologjike e emrit (e pashquar ose e shquar), dhe (2) afërsia lineare dhe ndërtimore me përcaktorin.

Kur emri është në trajtë të pashquar, sintaksa është zakonisht emfatike, dhe përcaktori shoqërohet domosdoshmërisht me një nyjë të përparme emfatike (p.sh. zot i madh). Kur emri është në trajtë të shquar dhe përcaktori vjen menjëherë pas tij, sintaksa është joemfatike, dhe përdorimi i nyjës së përparme është jo i detyrueshëm ose merr vlerë të dobësuar emfatike (p.sh. zoti madh / zoti i madh).

Përveç dy serive të nyjave (emfatike dhe joemfatike), ekziston edhe një seri e tretë, e ashtuquajtura nyjë e këputur, e cila dëshmon për sjelljen klitike me prirje

centripete të nyjës në raport me bujtësin (host), si dhe për bifunksionalitetin e saj: si element përcaktor dhe njëkohësisht si element lidhës në ndërtimin e sintagmës.

Ky sistem i shumëfishtë i nyjave të përparme përbën një rast të veçantë të hibriditetit morfosintaksor, ku ndërthuren karakteristika të tipologjisë analitike dhe sintetike, duke i dhënë gjuhës shqipe një profil të dalluar në arealin ballkanik dhe më gjerë.

“Çështje të diferencimit tekstor e semantik në brendinë e teksteve të vjetra shqipe” nga Evalda Paci



Në përmbajtjen e veprave të letërsisë së vjetër shqipe ka vend përherë për refleksione e vëzhgime që e shohin fjalën si burim interpretimesh qoftë të thelluara, qoftë ndërdispline. Pasqyrimi i ndikimit kulturor të trashëgimisë liturgjike romane përbën një prej argumenteve më të trajtuara në hulumtimet e studiuesve që u kanë kushtuar punime të mirëfillta studimore këtyre veprave dhe elementeve të përveçme të brendisë së tyre.

Në këtë vështrim, përpilimi i vëllimeve studimore që e rimarrin çështjen e dallimit të elementeve të caktuara në përbërje të teksteve të vjetra shqipe nënvizon rëndësinë e analizimit të përveçimeve latine dhe latino-romane në raport me kontekstin e hartimit të veprave, por edhe të vijimësisë së përdorimit të tyre në realizime të mëvonshme.

Vënia në dukje e diferencimeve në përdorime dhe përftesa në tekste të ngjashme, qoftë edhe brenda së njëjtës vepër, në të vërtetë orienton ndaj njohjes së receptimit të

tyre në tradita paraekzistuese, si dhe ndaj mundësisë së përdorimit të hershëm nën të njëjtin destinacion.

Edhe në një aspekt të evidentimit të elementeve të sipërcituara nga veprat e letërsisë së vjetër shqipe, pasqyrimi i tyre në glosarët që shoqërojnë studimet tematike apo fjalorët me orientim nga shqyrtimet etimologjike, në konkordancat që pasurojnë botimet kritike e filologjike, përbën një shtysë për të thelluar më tej njohjen e historikut të qarkullimit të tyre në kohë të mëhershme.

Fjalë kyçe: Elemente latine; botim kritik e filologjik; glosar; traditë e mëhershme; letërsi e vjetër shqipe.

Të tjera

**Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë uron akademik emeritus
Rexhep Meidanin: Gëzuar ditëlindjen!**



Rexhep Meidani ka lindur më 17 gusht 1944.

Kryesia e Akademisë së Shkencave dhe kolegët i urojnë në 81- vjetorin e lindjes akademik emeritus Rexhep Meidanit jetë të gjatë e krijimtari të pasur.

Akad. emeritus Meidani ka kryer studimet universitare dhe pasuniversitare për fizikë në Shqipëri dhe në Francë.

Ai është anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë që nga viti 2003.

Ka qenë President i Shqipërisë gjatë viteve 1997- 2002.

Akad. emeritus Meidani, përveç veprimtarisë së pasur pedagogjike e shkencore, ka shkruar dhjetëra libra shkencorë, filozofik-shkencorë dhe monografi.

Pjesë e veprave të tij janë edhe librat publicistikë dhe eseistikë.

Për më shumë, lexo linkun:

https://akad.gov.al/wp-content/uploads/2024/02/R_Mejdani.pdf

www.akad.gov.al

In memoriam

Kujtojmë në ditën e tij të lindjes Eqerem Çabej



Eqerem Çabej (1908–1980). Gjuhëtar, profesor, akademik, Mësues i Popullit. Lindi në Gjirokastrë, ku mori mësimet e para. Kreu gjimnazin në Klagenfurt (Austri) dhe ndoqi studimet e larta për gjuhësi krahasuese indoeuropiane dhe albanologji në Universitetin e Gracit e më pas në Universitetin e Vjenës, ku u diplomua si “Doktor në filozofi” (1933). Punoi si mësues i gjuhës dhe letërsisë shqipe në shkolla të mesme në Shkodër, Elbasan, Gjirokastrë, Tiranë. Në v. 1940 u mënjana nga arsimi për shkak të përkrahjes së veprimeve antifashiste të nxënësve dhe u dërgua në Romë ku punoi për atlasin gjuhësor shqiptar. U kthye në atdhe në v. 1944. Punoi në Institutin e Shkencave (shih) dhe që ndër pedagogët e parë të Institutit të Lartë Pedagogjik Dyvjeçar (shih). Me themelimin e UT rifilloi veprimtarinë mësimore si pedagog i lëndëve historike e gjuhës shqipe dhe fonetika historike e shqipes. Është një ndër anëtarët themelues të ASHSH (shih) dhe anëtar i Presidiumit të saj. Punoi në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë (shih) deri në fund të jetës. Vdiq në Romë.

Për afër një gjysmë shekulli E. Ç. dha ndihmesa të rëndësishme veçanërisht në arsimin e lartë dhe në gjuhësinë shqiptare. Hartoi tekstet e disa lëndëve kryesore, ishte bashkautor në një varg veprash kolektive. Veprimtaria e tij shkencore u shtjellua kryesisht në gjuhësi, por u shtri edhe jashtë saj, sidomos në folklor, etnografi, histori të letërsisë. Fusha themelore e tij ka qenë historia e gjuhës, e vështuar në aspektet e problemet më të ndryshme të saj. Vendin qendror e zënë studimet etimologjike dhe gjuha e autorëve të vjetër e botimi filologjik i veprave të tyre. Por mjaft peshë kanë edhe fonetika e gramatika historike e shqipes, historia e përgjithshme e shqipes me problemet e prejardhjes së saj, të marrëdhënieve me gjuhët motra indoeuropiane, me gjuhët ballkanike e me gjuhë të tjera. Ai argumentoi në mënyrë bindëse prejardhjen ilire të gjuhës shqipe e të popullit shqiptar, autok-toninë e tij në trevat ku banon sot, vuri në dukje rolin dhënës të shqipes ndaj gjuhëve me të cilat ra në kontakt dhe unitetin e kulturës materiale e shpirtërore shqiptare. Ndihmesa me rëndësi ka dhënë E.Ç. edhe për dialektologjinë e onomastikën, si edhe për kodifikimin e gjuhës letrare. Nga veprat e para të tij, përveç artikujve, mund të përmenden: “Elemente të gjuhësisë dhe të literaturës shqipe, me pjesa të zgjedhura për shkollat e mesme” (1936), “Për gjenezën e literaturës shqipe” (1939), “Shqiptarët ndërmjet Lindjes dhe perëndimit” (1994), “Hyrje në historinë e gjuhës shqipe” (1947, 1958), “Fonetika historike e shqipes” (1958). Ndër veprat kryesore të tij janë: “Studime etimologjike në fushë të shqipes” (në shtatë vëllime, 1976–2006); “Meshari” i Gjon Buzukut (1555)”, botim kritik në dy vëllime, i pajisur me një studim të gjatë hyrës (1958), “Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe” (1967)”, “Studime për fonetikën historike të gjuhës shqipe” (1988). E.Ç. është anëtar i komisionit hartues të “Fjalorit të gjuhës shqipe” (1954), anëtar i komisioneve për përpunimin e terminologjisë të shumë degëve të shkencës e të teknikës dhe i komisioneve që punuan për hartimin e udhëzuesve drejt-shkrimorë nga v. 1948 deri në “Drejtshkrimin e gjuhës shqipe” (1973); bashkautor (me A. Xhuvanin) në dy trajtesat “Parashtesat” dhe “Prapashtesat e gjuhës shqipe” (1956, 1962). Me botimet e shumta edhe në revista gjuhësore të huaja, si dhe me pjesëmarrjet në forume shkencore ndërkombëtare E.Ç. u njoh si autoriteti shkencor më në zë në albanologji. Vepra e tij është botuar në Kosovë nën titullin “Studime gjuhësore” (1976 e në vijim; deri tani nëntë vëllime). E.Ç. ka marrë Çmimin e Republikës të shkallës së parë (dy herë) dhe është dekoruar me Urdhrin “Nderi i Kombit”.

Akademia e Shkencave kujton me nderim, në ditën e lindjes, themeluesin e arkeologjisë shqiptare Hasan Cekën



Si sot 125 vjet më parë, më 25 gusht 1900, lindi Prof. Hasan Ceka. Ai njëkohësisht njihet edhe si njeriu që vuri themelet e arkeologjisë shqiptare.

Hasan Ceka studioi në Vjenë dhe pas kthimit në Shqipëri, në vitin 1930, punoi në Bibliotekën Kombëtare. Ai krijoi një koleksion arkeologjik, të cilin edhe sot e trashëgon Biblioteka e Institutit të Arkeologjisë. Në të njëjtën kohë përfaqësoj Shqipërinë pranë misionëve të huaja në Apolloni e Butrint.

Në vitin 1947 drejtoi ekspeditën e parë arkeologjike në Apolloni si dhe punën për krijimin e Muzeut Arkeologjik Etnografik në Tiranë. Në 1956-të rikthehet në Apolloni dhe do ti kushtoj qytetit antik tërë veprimtarinë e tij kërkimore e studimore. Prof. Cekës i takon në të njëjtën kohë edhe merita e zbulimit të një kompleksi arkitektonik në afërsi të ndërtesës së Agonoteteve, gjithashtu edhe nimfeut të qytetit dhe e shumë monumenteve të tjera.

Krahas gërmimeve në Apolloni Prof. H.Ceka tregon një kujdes të veçantë për grumbullimin dhe ruajtjen e trashëgimisë sonë monetare antike e mesjetare. Ai ishte një specialist i studimit të monedhave antike, dhe këto studime ai i kurorëzoi me botimin e veprës së njohur "Probleme të numizmatikës ilire" të botuar më 1965 si dhe gjithashtu ai

përgatiti edhe veprën "Monetat e Dyrrahut dhe Apollonisë".



Prof. H. Ceka ishte njohës i mirë i greqishtes së vjetër dhe latinishtes duke u bërë kështu një nga bashkëautorët kryesorë në përkthimin dhe përgatitjen në shqip të vëllimit "Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë". Ai është autor i shumë artikujve, studimeve e kumtesave të botuara në revistat shkencore brenda e jashtë vendit. Këto studime janë përmbledhur e botuar në vëllimin "Në kërkim të historisë ilire", Prof. Hasan Ceka u nda nga jeta më 2 nëntor 1998.

www.akad.gov.al

Më 30 gusht 2025 mbushen 11 vjet nga largimi nga jeta i akademikut të nderuar, prof. dr. Shaban Demiraj



Në vijim po japin një material të përgatitur nga prof. dr. Rami Memushaj

NJË JETË NË SHKENCË: NË NDERIM TË AKADEMIKUT PROF. DR. SHABAN DEMIRAJ

Më 30 gusht 2014, pas një lëngimi të gjatë, u nda nga jeta akademiku Shaban Demiraj, i fundmi i brezit të gjuhëtarëve që e ngritën gjuhësinë shqiptare në nivelin e gjuhësisë ballkanase. Ai lindi në Vlorë, më 1 janar 1920, në familjen e Sulejman Demirajt, i njohur si mulla Sulua, klerik mysliman, veprimtar i lëvizjes kombëtare në prag të Pavarësisë, i cili, së bashku me atdhetarë të tjerë, si Kristo Karbunara, Ibrahim Shyti, Osman Haxhiu etj., punoi për përhapjen e mësimit të shqipes në Vlorë e rrethina.

Vlora e atëhershme ishte një qytet i vogël, pa ndonjë peshë në jetën administrative të vendit, por një vatër e ndezur atdhetarie, që shquhej edhe për një traditë të trashëguar qysh nga shek. XIX të kujdesit për shkollimin e fëmijëve. Familjet vlonjate nuk kursenin për edukimin e fëmijëve të tyre, madje familjet e pasura merrnin

edhe mësues nga jashtë për t'u mësuar gjuhë të huaja. Një ndër këto familje arsimdashëse ishte edhe ajo e mulla Sulos, që, pavarësisht se ishte e numërt dhe me të ardhura të pamjaftueshme, u kujdes për shkollimin e fëmijëve të vet.

Arsimin plotor 5-vjeçar e mbaroi në shkollën e parë shqipe të lagjes Muradie, me mësues Jani Mingën, Ibrahim Shytin etj. Shokë të tij të shkollës ishin Ali Asllani, Nexhat Hakiu, Petro Markua etj. Pranë shtëpisë së tij, Ibrahim Shyti kishte librarinë "Shpresa", ku merrte libra hua. Kështu iu forcua dëshira për të lexuar, po edhe për të mësuar gjuhë të huaja. Tregonte se, kur ishte 13 vjeç, i kishte rënë në dorë një gazetë me reklamën e një metode për mësimin e frëngjishtes. Ia tregoi gazetën babait dhe, pasi ky i dha të holla për ta porositur, i nisi botuesit francez zarfin me porosinë, duke shkruar në anën për adresën e dërguesit "Dr." në vend të "Dërg." Metoda i erdhi në një zarf, në të cilin në adresën e marrësit kishin shkruar: "Dr. Shaban Demiraj", duke menduar se porositësi do të ishte ndonjë doktor shkencash! Ishte gati si një profeci për të ardhmen e këtij fëmije që, nga një vend i humbur i Ballkanit, porosiste një metodë të frëngjishtes.

Shkollën e mesme e kreu në medresenë e Tiranës, ku pati si mësues mjaft emra të dëgjuar të arsimit shqiptar të atyre viteve. Aty pasuroi edhe më tej njohjen e gjuhëve, duke mësuar arabishten, persishten e anglishten, veç turqishtes e italishtes që i kishte mësuar në shtëpi.

Studimet e larta i filloi në Universitetin e Romës, por kreu vetëm dy vjetët e parë, për shkaqe që nuk vareshin prej tij.

Pas Luftës, megjithëse me diplomën e shkollës së mesme dhe vëlla i dy dëshmorëve të vdekur në kampet naziste të Gjermanisë, nuk u dërgua për studime në vendet e demokracisë popullore si shumë moshatarë të tij. Kështu që zuri punë në Agjencinë Telegrafike Shqiptare, e cila kishte nevojë për njohës të gjuhëve të huaja. Më 1946 regjistrohet në degën e gjuhës shqipe dhe të letërsisë të Institutit Pedagogjik 2-vjeçar dhe, me përfundimin e studimeve më 1948, emërohet mësues në gjimnazin e Gjirokastrës e më pas transferohet në shkollën pedagogjike të Tiranës. Në vitin 1954 caktohet asistent pranë katedrës së gjuhës shqipe të Institutit të Lartë Pedagogjik, ku gjatë viteve 1954–1955 dha edhe provimet plotësuese për diplomën përkatëse.

Që nga 1954-a e deri më 1990 punoi në katedrën e gjuhës shqipe të Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës, të cilën e drejtoi për 28 vjet, nga 1962 deri më 1990. Në degën e gjuhës shqipe dhe të letërsisë të këtij Fakulteti dha lëndë të ndryshme, si histori e gjuhës së shkruar (shek. XVII–XIX), morfologji e sotme, gramatikë historike dhe gjuhësi ballkanike.

Morfologjia e shqipes së sotme dhe gramatika historike kanë qenë dy nga disiplinat gjuhësore bazë të kurrikulës së degës së gjuhës shqipe dhe të letërsisë. Të dyja ishin lëndë shumë të vështira, por shpjegimi mjeshtëror i profesorit i bënte ato të dashura për studentët. Ai rrëfente që, përpara se të merrte përsipër të jepte gramatikën

historike, iu vu studimit të rumanishtes (të cilën arriti edhe ta fliste), maqedonishtes, bullgarishtes, greqishtes së re e serbishtes, por edhe të rusishtes, për shkak të literaturës së pasur gjuhësore, por edhe sepse metodat për mësimin e gjuhëve të Ballkanit ishin kryesisht në këtë gjuhë. Në punë i hynë sidomos gjuhët klasike, latinishtja dhe greqishtja e vjetër, të cilat i kishte mësuar kur kishte qenë student në Romë. Njohu për qëllime studimi edhe gjuhë të tjera, si spanjishten, portugalishten, armenishten e sanskritishten. Shkruante e fliste lirisht në gjermanishte, anglishte, italishte e frëngjishte. Pra, gramatika historike kishte gjetur mjeshtrin e vet, gjë që u provua shumë shpejt.

Si pedagog dhe si drejtues i katedrës së gjuhës shqipe për gati tre dhjetëvjeçarë, prof. Demiraj ka lënë gjurmë të pashlyeshme. Mijëra studentët e tij që kanë shërbyer e shërbejnë ende në sektorin e arsimit dhe në sektorë të tjerët të tjerë në të katër anët e vendit, ruajnë për të një respekt të thellë. Këtë respekt të studentëve dhe të kolegëve ai e fitoi me sjelljen korrekte, qëndrimet parimore dhe me frymën e lartë të kërkesës. Në raportet me kolegët e studentët, ai ishte i rreptë por i drejtë, kërkues por i gatshëm për të ndihmuar. Ai udhëhoqi drejtpërdrejt kualifikimin shkencor të pedagogëve më të rinj të katedrës, duke përgatitur një grup gjuhëtarësh, që u dalluan shpejt për prodhimin shkencor të tyre. Nën drejtimin e tij, katedra e gjuhës shqipe u bë në ato vite një nga njësitë pedagogjiko-shkencore më të dalluara të Universitetit të Tiranës.

Por profesori nuk u mjaftua vetëm me punën mësimore. Zotërimi i një numri të madh gjuhësh të huaja dhe njohja e thellë e literaturës gjuhësore për shqipen, ishin dy premisa pozitive, por jo të mjaftueshme, për t'u marrë me veprimtari shkencore. Duheshin edhe prirje, të cilat nuk i mungonin. Prova të talentit të vet ai kishte dhënë që në rininë e hershme. Më 1937, kur ishte vetëm 17 vjeç, pati botuar shkrimin e parë në gazetën "Jeta e re", që dilte në Vlorë. Që nga ai vit e deri më 2011, kur shkroi artikullin e fundit, janë plot 74 vjet veprimtari krijuese. Një jetë e gjatë njeriu në letrat shqipe, gjatë së cilës botoi 13 vepra gjuhësore, tri të tjera me bashkautorësi dhe kontribues për pjesën e shqipes në katër vepra të botuara në Europë; 10 tekste mësimore universitare, 4 për shkollat e mesme si autor i vetëm dhe 5 tekste të tjera si bashkautor kryesor; 6 transkriptime dhe përshtatje veprash të autorëve të Rilindjes, si Naim Frashëri, Sami Frashëri e Gavril Dara i Riu; tri përkthime veprash letrare; dhe mbi 260 artikuj e kumtesa, të botuara në revista shkencore të rreth 20 vendeve.

Gjithë kjo veprimtari e bëri emrin e tij shumë të njohur në rrethet linguistike të Europës, gjë që e dëshmojnë pjesëmarrja e tij në kongrese e konferenca shkencore ndërkombëtare, ligjëratat e mbajtura në universitete europiane me emër, njohjet dhe letërkëmbimi i tij me shumë gjuhëtarë europianë e amerikanë.

Për veprimtarinë e tij të pasur shkencore, ai u pranua anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, në vitet 1993–1997 u bë kryetar i saj dhe në vitin 2006 u zgjodh "akademik i përjetshëm". Qe anëtar i Akademisë Qendrore Europiane të Shkencave dhe

të Arteve, anëtar nderi i Akademisë Diplomatike të Londrës, anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe nënkryetar i Shoqatës Ndërkombëtare të Studimeve të Europës Juglindore (AIESEE).

Puna e tij është vlerësuar me shumë tituj e çmime. Më 1972 iu dha titulli “Profesor”, më 1977 “Mësues i Popullit” dhe më 1990 “Profesor i merituar”; laureat i dy Çmimeve të Republikës, njëri i Klasit të Dytë dhe tjetri i Klasit të Parë; i dekoruar në vitin 2000 me Urdhrin “Mjeshtër i Madh”. Më 2001, bashkia e Vlorës i dha titullin “Qytetar nderi” dhe një rrugë të qytetit i vuri emrin e tij.

Veprimtarinë e vet botuese e nisi me shkrime patriotike në shtypin e kohës, duke vijuar me artikuj për fenë myslimane, që dolën në shtypin e kohës së Luftës; në të ri shkroi edhe poezi. Më vonë vijoi me përkthime, duke shqipëruar veprat “Jeta dhe lundrimet e Kristofor Kolombit” (botuar më 1944) dhe “Tregime prej Shekspirit” (1944, e pabotuar). Këtij pasioni të hershëm do t’i kthehet 15 vjet më vonë, më 1959, me romanin “Martin Iden” të Xhek Londonit, që ka njohur tri botime. Pas Luftës, luhatet mes letërsisë e filologjisë, duke botuar në gazetën “Mësuesi” e në revistën “Arsimi popullor” artikuj për çështje të përgatitjes së mësuesve dhe të mësimin të gjuhës shqipe e të letërsisë në shkollë; në revistën “Nëntori” shkruan për autorë vendës e të huaj.

Falë gjuhëve që njihte mund të ishte bërë një përkthyes i talentuar, siç mund të ishte bërë edhe studiues me emër i letërsisë. Por një rrethanë ndikoi që të hiqte dorë nga këto prirje të rinisë. Sikundër shkruan në shënimet biografike, qysh kur jepte provimet në Institutin Pedagogjik, kishte tërhequr vëmendjen e prof. Kostaq Cipo, me sugjerimin e të cilit u emërua në Institutin e Shkencave. Profesor Cipoja e ngarkoi të shfletonte literaturën albanologjike të Bibliotekës Kombëtare, gjë që e ndihmoi të konsolidonte njohuritë për shqipen. Ka shumë gjasa që, gjatë kohës së shkurtër që qëndroi këtu (sepse përsëri e transferuan në shkollën pedagogjike të Tiranës), të ketë nisur punën për studimin e gjuhës së Jul Varibobës. Studimi, që u botua më 1953 në tre numra të revistës “Buletin i Institutit të Shkencave”, u prit shumë mirë dhe duket se përcaktoi të ardhmen e tij. Më pas, u mor me gjuhën e Sami Frashërit, duke shkruar një punim tjetër të gjatë me më shumë se 40 faqe, që e botoi më 1955 në “Buletin për shkencat shoqërore”. Një tjetër studim bëri për lëvrimin e gjuhës shqipe gjatë shek. XIX, që u botua më 1958 e 1959 në dy numra të “Buletinit për shkencat shoqërore”.

Duke qenë se disiplina kryesore që iu ngarkua të jepte ishte morfologjia, edhe kërkimet e mëvonshme i përqendroi në këtë fushë, në fillim në morfologji të sotme dhe, më vonë, në gramatikë historike. Fryt i kësaj veprimtarie kërkimore 60-vjeçare janë një varg monografish e tekstesh universitare si dhe një numër shumë i madh artikujsh. Nga fusha e morfologjisë së sotme prej tij kemi monografitë “Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe” (1972), “Sistemi i lakimit në gjuhën shqipe” (1975), tekstin universitar në dy pjesë “Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe” (1961 e 1963), e para vepër që trajton në

mënyrë të plotë sistemin morfologjik të shqipes, si edhe kreun e foljes në gramatikën akademike të shqipes (1976). Po aq e pasur është veprimtaria e tij botuese edhe në fushën e gramatikës historike, që nis me tekstin në dy vëllime “Morfologjia historike e gjuhës shqipe” (1973, 1976) dhe kulmon me veprën madhore “Gramatikë historike e gjuhës shqipe” (Tiranë, 1986 dhe Prishtinë, 1988), e cila është quajtur “Bibla e gjuhës shqipe”. Për nga gjerësia e problemeve të cekura dhe thellësia e shpjegimit të evolucionit të shqipes, kjo gramatikë është kthyer në një libër pune shumë të domosdoshëm, të cilit i referohen të gjithë ata që merren me gramatikën e shqipes. Pikërisht, për nivelin e lartë shkencor të kësaj vepre, Akademia e Shkencave e Austrisë i kërkoi autorit hartimin e një varianti në gjermanisht të saj, që u botua në Vjenë më 1993. Për nevoja të mësimdhënies së gramatikës historike në degët e gjuhës shqipe të universiteteve tona, autori hartoi edhe një version të shkurtuar, që u botua në vitin 2002.

Për të zbuluar dhe shpjeguar ndryshimet që kanë pësuar fjalët dhe lëvizjet në sistemet e eptimit, morfologjia historike krahason format e shqipes së sotme me format e dokumentuara të periudhave më të hershme të saj ose të gjuhëve huazuese, duke zbuluar ndërrimet fonetike që kanë pësuar format më të vjetra për të përfunduar në gjendjen e sotme. Por krahasimi i formave nuk mund të bëhet pa njohjen e thellë të fonologjisë historike, gjë që jo vetëm e nxiti profesorin të thellonte dijet e tij edhe në këtë fushë, por edhe të grumbullonte një përvojë të pasur. Njohjen e thellë të fonologjisë historike të shqipes si dhe të zhvillimeve të përbashkëta dhe të ndikimeve të ndërsjella të gjuhëve të Ballkanit, i dëshmoi në dy vepra të tjera të rëndësishme: “Gjuhësi ballkanike” (1994), botuar edhe maqedonisht po atë vit, dhe “Fonologjia historike e gjuhës shqipe” (1996).

Por ndihmesat e prof. Demirajt nuk mbyllen me prurjet në fushën e gramatikës. Gjatë dhjetëvjeçarëve që u mor me studimin e gramatikës dhe të historisë së shqipes, iu forcua bindja se historia e një gjuhe është e lidhur ngushtë me historinë e bartësve të saj. Si rrjedhim, pasi kishte parë gjymtyrën e parë të binomit gjuhë e një populli – histori e tij, nga fundi i viteve ‘80 të shekullit të kaluar e deri në fund të dhjetëvjeçarit të parë të shekullit tonë e përqendroi vëmendjen në gjymtyrën e dytë të këtij binomi, në historinë e popullit shqiptar, duke dalë kështu kuadri i ngushtë i problemeve historike të gjuhës. Fryt i punës për të ndriçuar aspekte të historisë së popullit tonë me të dhëna gjuhësore janë veprat “Gjuha shqipe dhe historia e saj” (1988), botuar edhe italisht me titullin “La lingua albanese – origine, storia, struttura” (1997), “Prejardhja e shqiptarëve në dritën e dëshmive të gjuhës shqipe” (1999), botuar edhe anglisht me titull “The origin of Albanians (linguistically investigated)” (2006) dhe “Epiri, pellazgët, etruskët dhe shqiptarët” (2008). Në to, duke shfrytëzuar të dhënat gjuhësore, ai provon se shqiptarët janë pasardhës të ilirëve dhe gjuha e tyre është bijë e ilirishtes, që u quajt arbërishte dhe nga fillimi i shek. XVIII shqipe. Vepra e fundit i kushtohet posaçërisht trevës në jug të

Vjosës, të quajtur në lashtësi Epir. Me të dhënat që ka pasur në dorë – dëshmi historike dhe emra të lashtë e të rinj vendesh e njerëzish – ai arrin të provojë se epirotët e lashtë ishin gjithashtu ilirë, se gjuha e tyre ishte ilirishtja dhe se banorët e sotëm të Epirit, me përjashtim të popullsisë greke të vendosur në pjesët jugore të tij dhe të enklavave greke brenda kufijve të Shqipërisë politike, janë pasardhës të ilirëve. Në këtë mënyrë, duke provuar ilirësinë e Shqipërisë së Jugut dhe të gjuhës së banorëve të saj, ai hedh poshtë mëtimet greke për karakterin grek të Epirit. Këto tri vepra përbëjnë një shembull të dobisë së studimeve ndërdisiplinore për ndriçimin e çështjeve të vështira historike, siç është ajo e gjenezës së popullit tonë.

Veç veprave të mësipërme, prof. Demiraj ka botuar edhe dy vepra me karakter biografik, njëren për jetën e prof. Eqrem Çabejt (1990) dhe një tjetër për disa figura të shquara të gjuhësisë shqiptare (2003).

Me 7 mijë faqe të shkruara, nga të cilat rreth një e treta libra e artikuj në gjuhë të huaj (gjermanisht, anglisht, italisht e frëngjisht), prof. Demiraj ka vendosur një rekord në shkencën shqiptare. E megjithatë, ai nuk ndiente lodhje, ishte gjithnjë i papërtuar për të nxënë. Aty nga mosha 85-vjeçare mësoi edhe përdorimin e kompjuterit, me të cilin shkroi disa nga librat e fundit. Pas veprës së fundit, kishte ndër mend të shkruante një libër për mesapët dhe një tjetër për mësuesin e tij, Jani Mingën. Për të parin, në jetëshkrimin e shkruar prej tij lexojmë: “Kam dëshirë që t’i përvishem punës për hartimin e një monografie për Mesapët e Italisë Jugore, për të cilët disa vjet më parë kam shkruar nja dy artikuj. Dhe për këtë qëllim kam grumbulluar edhe disa materiale. Por në gjendjen e sotme shëndetësore, nuk mund t’i hyj një pune të tillë.” Shëndeti, që vinte duke iu përkeqësuar, nuk e la t’i përmbushte këto dëshira. Nga viti 2012 zuri shtratin për të mos u ngritur më.

Natyra i dhuroi prof. Demirajt një jetë të gjatë, pjesën aktive të së cilës ai e shfrytëzoi duke punuar pa u lodhur për t’i dhënë shqipes një numër kaq të madh veprash. Ky sukses nuk do të ishte arritur pa kombinimin e disa rrethanave jetësore me cilësitë pozitive të karakterit të tij, si etja e pashuar për dije, pasioni për shkencën dhe vullneti i pashoq. Falë këtyre cilësive, edhe pse i shkolluar brenda vendit, ai arriti të barabitej me kolegët në Institutin e Shkencave dhe në Fakultet që ishin diplomuar në universitete europiane, duke u bërë një nga emrat më të shquar të gjuhësisë shqiptare, krahas Eqrem Çabejt, Mahir Domit e Idriz Ajetit.

Jeta e këtij patriarku të gjuhës shqipe do të mbetet një shembull i rrallë i përkushtimit ndaj punës dhe kërkimit shkencor, kurse vepra e tij një kontribut me vlerë të paçmuar për albanologjinë. Veç kësaj trashëgimie vlerash e veprash, ai u ka lënë këtë amanet brezave të rinj të intelektualëve shqiptarë dhe shtetit:


“Mesazhi im për intelektualët tanë të rinj është që të punojnë me përkushtim, secili në fushën e tij, për të ndihmuar në zhvillimin dhe përparimin e gjithanshëm të

vendit tonë. Shqipëria ka një potencial intelektual të pasur, i cili duhet nxitur që t'i shfrytëzojë sa më shumë aftësitë e tij për të mirën e vendit tonë. Por, për këtë qëllim, intelektualët tanë të rinj edhe duhen ndihmuar me të gjitha mënyrat që të mos detyrohen të braktisin Atdheun dhe të shkapërderdhin energjitë e tyre në dhe të huaj."

Rami MEMUSHAJ

<https://bib.cobiss.net/biblioweb/direct/al/alb/cris/00751>

Ngushëllim për ndarjen nga jeta të Robert Papavramit



Komisioni i Përhershëm i Arteve pranë Akademisë së Shkencave i shpreh ngushëllimet më të thella violinistit me famë botërore Tedi Papavrami, për ndarjen nga jeta të Robert Papavramit, babait dhe mësuesit të Tij.

Shkolla shqiptare e violinës sot është më e varfër me këtë humbje, por ngushëllohem që trashëgimia artistike që Ai la pas vijon në lartësi të reja, kjo falë arritjeve Tuaja, i dashur Tedi.

Të rroni e ta kujtoni!

www.akad.gov.al

Ngushëllim për ndarjen nga jeta të Artur Zhejit



Qendra e Studimit të Arteve shpreh dhimbjen për ndarjen nga jeta të Artur Zhejit – gazetar, publicist dhe dramaturg që ka lënë gjurmë në skenën teatrore shqiptare. Në krijimtarinë e tij, fjala u bë reflektim i kohës dhe i shoqërisë, duke pasuruar jo vetëm medien dhe debatin publik, por edhe skenën tonë kombëtare.

Ngushëllime të singerta familjes, miqve dhe gjithë komunitetit artistik.

U prehtë në paqe.

Ngushëllim për ndarjen nga jeta të Naun Shundit



I ndarë nga jeta në moshën 66-vjeçare, Naun Shundi ishte akori, regjisori e dramaturgu që ia kushtoi jetën teatrit, duke e kurorëzuar atë në një simbiozë me teatrin "E zonja e bujtinës", ngritur në shtëpinë e tij.

I emëruar në Teatrin Kombëtar (asokohe Teatri Popullor) në vitin 1983, menjëherë pas diplomimit, Naun Shundi filloi të krijojë menjëherë figura që spikatën në shfaqje teatrale si "Monserati", "Frikë dhe mjerim në rajhun e tretë", "Vizita e damës plakë", "Ezopi", "Tiranozauri", "Oportunesku", "Gjethja", "Kush vjedh një këmbë, ka fat në dashuri", "Loja e pushimeve", "Fando e Lis", "Zoti godet me putër", "Këngëtarja tullace", "Në katin e dytë është parajsa", "Kopshti me dallëndyshe", "Darka e të marrëve", "Shtrigat e Salemit", "Drejt perëndimit", "Kontrata", "Darka e gabuar", "Zoopark", "Mysafiri i mallkuar", "Henry IV", "Pleshti në vesh", "XXL TV" "Liri në Bremen", "Tri motrat", "Nata arabe", "Pushteti i grave", "Tag", "Galaksia", ku një nga rolet e fundit, ai i Pjetrit të "Kapter Behari" do të mbahet gjithmonë mend për një figurë të ndërtuar me shumë kujdes e një plan të thellë.

Si regjisor, Naun Shundi mbahet si një prej atyre që e patën për zemër dhe e

promovuan dramaturgjinë shqipe me bashkëpunime me autorë si Stefan Çapaliku, Rexhep Qosja, Petrit Ruka, Vangjel Kozma, por edhe me pjesë të tijat, të cilat mishëronin arritje të teatrit absurd. Nga këto shfaqje kujtojmë "Misto", "Mbretëresha", "Epopëja e supës", "Gjethja", "Nderi i Kombit", "XXL TV", "Vërtitu kokë e prerë", "Të gjithë janë të çmendur", "Çiftet", "Qeni", "Osman Taka", "Babai", etj.

Trashëgimia që la pas Naun Shundi është nga ato që nuk shlyhen lehtë në kohë.